



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 3917 prot.

Tiranë, më 05.09.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1739, datë 12.01.2015.

SHOQËRISË “C.G.C” SH.P.K
Rruga “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, Kati 13, Tiranë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “C.G.C” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1739, datë 12.01.2015, për mineral flish me zaje kuarci, në objektin “Pervallë”, Librazhd, Qarku Elbasan.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.436, datë 14.01.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.541/12, datë 15.01.2019, është propozuar revokimi i lejes nr.1739, datë 12.01.2015, për mineral flish me zaje kuarci, në objektin “Pervallë”, Librazhd, Qarku Elbasan, sepse nuk keni filluar punë në objekt, duke mos respektuar kërkesat e Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve, është i mbështetur në paragrafin “II” të germës “b”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1739, datë 12.01.2015, për mineral flish me zaje kuarci, në objektin “Pervallë”, Librazhd, Qarku Elbasan,** që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.1739, datë 12.01.2015, për mineral flish me zaje kuarci, në objektin “Pervallë”, Librazhd, Qarku Elbasan.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

